



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1791/ 11 prot.

Datë 31 .07.2026

V E N D I M
Nr. 905 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 862/2026, datë 25.06.2026 për procedurën e prokurimit me “E hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-88226-06-01 2026, me objekt “Blerje tonera per printera dhe fotokopje”, me fond limit: 1,666,666.00 lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 12-06-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Ankimues: Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me NIPT L82428011G, me adresë: Rruga “Fortuzi”, Nr. 66/I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shijak , me adresë: Lagja “Erzen” Shijak.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 25.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.862/2026, ku vendosi:

- 1.Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF 88226-06-01-2026, me objekt “Blerje tonera per printera dhe fotokopje”, me fond limit: 1,666,666.00 lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 12-06-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.*
 - 2.Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK për procedurën e prokurimit sipër cituar.*
 - 3.Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet dhe sqarimet me shtojcën përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*
 - 4.Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
 - 5.Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.*
 - 6.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 7.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr.3676 prot., datë 03.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1791/7 prot., datë 08.07.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 862/2026, datë 26.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik duke modifikuar dokumentat standarte si dhe duke publikuar shtojcën.

I.3. Me shkresën nr.3687/1 prot., datë 03.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1791/8 prot., datë 09.07.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 862/2026, datë 26.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik duke modifikuar dokumentat standarte si dhe ka përcjellë shtojcën e modifikuar fizikisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.3676 prot., datë 08.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1791/7 prot., datë 08.07.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 862/2026, datë 26.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik duke modifikuar dokumentat standarte si dhe duke publikuar shtojcën.

II.2. Me shkresën nr.3687/1 prot., datë 08.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1791/8 prot., datë 09.07.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 862/2026, datë 26.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik duke modifikuar dokumentat standarte si dhe ka përcjellë shtojcën e modifikuar fizikisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Nga verifikimi i sistemit të prokurimit elektronik për procedurën objekt ankimi, Komisioni vlerëson se nga verifikimi i sistemit elektronik rezulton se autoriteti kontraktor ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit si dhe ka publikuar shtojcën në SPE, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 862/2025, datë 26.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit me prokurimit “E hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF 88226-06-01-2026, me objekt “Blerje tonera per printera dhe fotokopje”, me fond limit: 1,666,666.00 lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 12-06-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Kryetar
Ismail Shehu